



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

Tiranë më, 22.10.2018

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR HAPJEN E
PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E
SHQIPËRISË) – SKJE (MALI I ZI) PËR QARKULLIMIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR
DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS”**

Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.10.2018 shqyrtoi projektligjin, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin, Znj. Rovenë Voda, Zëvendësministre e Brendshme, Z. Xhevahir Karaj, drejtues i parë dhe Znj. Anisa Boci, specialiste në Drejtorinë Juridike pranë Departamentit për Shërbimet Mbështetëse.

Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, neni 100 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Projektligji ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës, në kuadër të lehtësimit të qarkullimit në pikën e përbashkët kufitare.

Marrëveshja është inicuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit midis dy shteteve dhe për të krijuar kushte sa më të mira për zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, në kuadër të lehtësimit të qarkullimit në pikën e përbashkët kufitare, duke marrë masa të përbashkëta.

Pika e kalimit kufitar Zogaj është një pikë e përbashkët e kalimit kufitar në Bashkinë e Shkodrës, në kufirin me Malin e Zi, e cila ndodhet 11 km në veriperëndim të qytetit të Shkodrës, në bregun e liqenit të Shkodrës. Kjo pikë do të jetë e hapur 24 orë në ditë për qarkullim ndërkombëtar rrugor dhe qarkullim të personave në liqenin e Shkodrës.

Nga kjo marrëveshje mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, pritet që:

- të lehtësohet lëvizja e banorëve të zonave afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të Malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit,
- të shkurtohet distanca mes zonave;
- të reduktohet fluksi i kalimit në pikën e kalimit doganor të Murriqanit gjë e cila do ishte shumë lehtësuese gjatë sezonit turistik;
- të ketë kontroll më të mirë të kufirit në zonën e Zogajt;
- të kontrollohet bregut i liqenit të Shkodrës, si dhe
- të shfrytëzohen vlerat turistike të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të kryhet nga Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve, i cili ka shërbyer edhe për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin. Për qeverinë e Shqipërisë, autoritet kompetent do të jetë Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, ndërsa për qeverinë e Malit të Zi, autoritet kompetent do të jetë Policia e Malit të Zi dhe Ministria e Brendshme.

Efektet financiare

Kostot financiare të parashikuara në marrëveshje do të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Diskutimet në Komision

Pas prezantimit të projektligjit Komisioni kërkoi sqarime mbi afatet kohore dhe mbi qarkullimin. Pala e ftuar sqaroi se kjo pikë kufitare do të shërbejë jo vetëm për qarkullimin e personave, por dhe atë të mallrave. Pas sqarimeve komisioni votoi në parim, nen për nen dhe në tërësi projektligjin.

Aspekti procedural i projektligjit

Projektligji është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 “Për Marrëveshje ndërkombëtare.”

Dhe konkretisht nenit 18 pika 3 në të cilën thuhet “Aderimi/pranimi/miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për aderim/pranim/miratim Kuvendit.”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI